




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-13784/21 datë:17.06.2021



Npi – 01/185 datë: 28.06.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 28.06.2021 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VI- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 28.06.2021, (e hënë) në ora 10.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, znj.Arbenita Halimi, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamed Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi. Në mbledhje përveq anëtarëve të Kuverndit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli, Drejtoret, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati; Nga zyra Ligjore, z.Lulzim Muharremi, Nga njësiti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, z.Reshat Gashi; Nga OJQ "YAH" – z.Egzon Ahmeti; Nga RZSH-ë z.Muhamed Hoxha; Nga zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjafsheshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit.

Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Pyetje – Përgjigje,
2. Draft-Korriza Afatmesme Buxhetore 2022-2024, (pas diskutimit publik)
3. **Propozim-Vendim për shpronësimin e pronave në Z.K-Shtime, Petroviç, Reçak, Petrovë,**
4. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Kuvendit në Komisionin për ndarjen e Bursave për Studentë, për vitin akademik 2020/2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Shefki Dauti; Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës përveq pikës së 3. Kërkesa ka ardhur me vonesë dhe për këtë arsyre ne po kërkojmë scharime shtesë, por edhe sa u përket pronave që duhet të shpronësohen te pusht e ujësjellësit duhet të kemi scharime se çka do të bëjmë me ato prona. Për këtë arsyre unë kërkoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, për të gjithë por edhe përshëndetje për ata që po na përcjellin jashtë sallës së Kuvendit. Siç po shihet rendit të ditës po i mungon Ekstrakt-Procesverbali nga mbledhja e kaluar, por edhe nga disa mbledhje tjera të kaluara të Kuvendit edhe të KPF-së. Ne kemi kërkuar vazhdimesht, që disa mbledhje me radhë dhe prap po kërkojmë që të plotësohet stafi i Kuvendit edhe

me një zyrtarë, sepse aty është e pa mundur që i vetëm z.Idajet rexhepi me arritë me i përbmbushë të gjitha obligimet, dhe punët që kërkohen për Kuvend. Nuk e di pse nuk e marrin një zyrtarë, për Kuvend, kur dihet që ka zyrtarë në komunë që rrinë. Sa i përket pikës së 3 është mjaft diskutabile, sepse vërtetë unë nuk e di a don me mbetë ndonjë pronë komunale pa u dhënë, edhe ate në kohën e fushatës zgjedhore. Për këtë arsyе ne si vettvendosje jemi kundër, dhe kërkojmë që kjo pikë 3 të hiqet nga rendi i ditës. Për pikat tjera jemi dakord.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ne kemi edhe spjegimin ligjor nga zyrtari ligjor për sa i përket pikës së 3 që ka të bëj me shpronësimet. Në vazhdim Kryesuesja e lexi dokumentin e zyrtarit ligjor.

z.Naim Zejna; Përshtendetje, pajtohem me parafolësit plotësisht për problemet që i kemi e sidomnos me Procesverbalin që jemi mbrapa me 3-4 mbledhje, Procesverbalet duhet me ardhë menjëher sepse gjërat pastaj po harrohen se çka kemi thënë, kërkoj edhe unë që të plotësohet stafi i Kuvendit edhe me ndonjë zyrtarë, për me mujt me i kryer punët. Te pikat e rendit të ditës për KAB-in kërkoj që me na sçuaruar edhe pak Bujari. Ndërsa sa i përket pikës së 3 përgjegjësinë e merr zyrtari ligjor. Po ashtu kërkoj që te pika që ka të bëj me shpronësimet të hiqet pika 2 e propozim-vendimit që ka të bëj me shpronësimet e pronave të Sadik Abazit.

z.Fehmi Hysenaj; Përshtendetje, unë po kërkoj që para se ti miratojmë pikat e rendit të dietës, ekzekutivi të na sçarojë se a janë përfilluar të gjitha procedurat e shpronësimeve.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Bëri një përbledhje të propozimeve, dhe në vazhdim konstatoi kuorimin prej 18 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 1 votë “Për” me 15 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” nuk e aprovoi Rendin e Ditës të ardhur nga Kryesuesja dhe Kryetari i Komunës.**

* **Kuvendi i Komunës, me 14 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 4 vota “Abstenim” aprovoi Rendin e Ditës pa pikën e tretë të propozuar të rendit të ditës “Propozim-Vendim për shpronësimin e pronave në Z.K-Shtime, Petroviç, Reçak, Petrovë”.**

Pika 1

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Fehmi Hysenaj: Unë do ti paraqes dy pyetje me rëndësi të përgjithshme: E para qka ka ndërmend të bëj ekzekutivi ose drejtoria që merret me këtë punë, për rrjedhjen e kanalizimit fekal te lumi Shtimjanja në pikat më të frekuentuara të rinjëve sepse vërtetë aty kundërmon erë e rendë?

Pyetja e dytë, ndoshta nuk i përket Komunës por mergjithate Komuna duhet me ndërrmarrë veprime, sa herë që kalojmë rrugën për Prizren, në Carralevë te shkolla e vjetër është një rrjedhje e ujit të ujësjellësit, ndërkaq që ne po kemi mungesa te ujit në këtë kohë e atje rrjedhë vazhdimisht uji, kur do të veprohet për sanimin e kësaj rrjedhje të ujit?

z.Muhamed Ademaj: Kam këto pyetje: Pyetje për DKA-në, sa është numri i punëtorëve që punojnë në shkollën e mesme të lartë me fakultet të Edukimit? Pyetja e dytë për DKA-në, pse nuk shpallet konkurs, për ti zavendësuar këta punëtorë me master të shkencave të natyrës?

z.Ruzhdi Jashari: Kam këto pyetje: Po e përsëris pyetjen për të tretën here, që Ekzekutivi të na sjellë në Kuvend të gjitha vendimet të cilat nuk janë ekzekutuar, sepse e ka obligim, kemi psh. të pa zbatuar vendimin për deponinë Inerte, e shumë të tjera?

Pyetja tjetër që dua ta ngriti, është sa është numri i të punësuarve me kontratë mbi vepër si shërbime kontraktuale për secilën drejtori? Në fshatin Carralevë (që i kanë thënë te varri i partizanit) është krijuar një deponi e mbeturinave kur do të pastrohet sepse aty eshte një bukuri natyrore?

z.Rexhep Gashi: Kam këto pytje: Kam një pytje për DSHP-në, Pasqyret në këndet e vdekura drejtor, janë disa të thyera pse nuk po zëvendësohen me të reja? Pytja tjetër për DSHP-në, për gjatë rrugës “I. Rugova” deri te rrethi në Davidovc si dhe në anën tjetër për Ferizaj deri te rrethi te Lulishtja, qka është duke ndodhur pse nuk po mirëmbahet trotuari?

z.Naim Zejna: Kam këto pyetje: Kam një pyetje për sa i përket punës së Komisionit për Banesa, në cilën faze është puna e tyre, dhe cilat janë rekomandimet e tyre dhe kërkoi që në një mbledhje të radhës të na vien ato? Pytja tjetër për DSHP-në, qysh para 2-3 viteve është premtuar në të vërtet është marrë si vendim që të vendosen dy Pasqyra njëra te rruga “Komendant Kumanova” te dalja, dhe tjetra te rruga “Mic Sokoli” sepse është një kënd shumë problematik ku nuk shihet fare ajo kthesa?

z.Shefki Dauti; Kam këto pyetje: Po bëhet fjalë për Parkun e Qytetit në Shtime, nëse aty kalojmë në ora 12h. ose ora 1h. është kthyer në parking të qytetit, aty frekuentojnë shumë edhe fëmijët dhe është rrezik I madh, qka do të veproj drejtoria për me i ndalu automjetet, sepse ne e dime që është e lejuar vetem per banor dhe biznese, a ka mundesi me u vendos ndonjë Laurë elektronike ose diçka tjetër?

znj.Shqipe Rexhaj – DPUKGJ; Përshëndetje, Ishte një pyetje që kishte të bënte me kanalizimet kryesisht në rrugën “De Rada” kanalizime të cilat derdhen në Lumë, mirëpo me projektin e ndërtimit të Kolektorit i cili është duke vazhduar dhe kemi arritë dikund deri te Shtimja, dmth. Këtë vitë do të përfundojë qendra ku do të lidhen të gjitha kanalizimet në këtë kolektorë dhe do të barten deri në Vojnovc, kështu që po besoj se është çështje kohe dhe ky problem do të zgjidhet.

z.Hamëz Tërshani – DSHP; Përshëndetje, unë i mora pyetjet e adresuara te unë, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kontratën e mirëmbajtjes. Te pjesa e pasqyrave dmth. Ishin dy, po shpresoj që në afat shumë të shkurtë do të nbënshkruhet kontrata dhe kemi me intervenuar nëpër të gjitha pikat ku ka nevojë. Sa i përket pyetjes në sheshin e qytetit, po ju njofoj që banorët e asaj pjesë janë identifikuar prej Komunës, u janë dhënë leje, kështu që është detyrë e policisë tash e tutje për me mbikqyrë atë pjesë. Ndërsa sa i përket, vendosjes së Laurës, kemi me shiku me bërë zgjidhjen më të mire të mundëshme, për me funksionuar ajo pjesë.

znj.Agime Roshaj – DKA; Përshëndetje, sai përket pyetjes së z.Muhamed Ademaj, në fakt nuk e kuptova në përfundim për qka ishte se kujt me ju shpallë pozita, zëvendësimet e kujtë, ndërsa për statistik për numërin e saktë ju sjelli me shkrim në mbledhjen e radhës.

z.Muhamed Ademaj; Pyetja ime ishte sa është numri i punëtorëve që punojnë në shkollën e mesme të lartë me fakultet të Edukimit, fjala është për katër vjeçar? Pse nuk shpallet konkursi për ti zëvendësuar këta punëtorë me master të fakultetit të shkencave të natyrës?

z.Besnik Seferi; Kam këto pyetje: Përshëndetje, Shumë shkurt, pytja kishte me qenë kështu, meqenëse drejtori z.Hamzë Tërshani e dha një sçarim për shërbimet kontraktuale të mirëmbajtjes, mirëpo nuk e di se sa është duke u respektuar gjendja në teren te trotuaret te kanalizimet edhe te parku i qytetit i cili është në gjendje jo të mire, sidomos te kapakët e pusetave, pyetja është kështu, sa është shuma kontraktuese e mirëmbajtjes së parqeve, qytetit dhe trotuareve në përgjithësi e cila nuk është duke ndodhur, kur do të pastrohen këto njëher e përgjithëmonë?

z.Reshat Mujota; Kam këto pyetje: Unë nuk desha me marrë fjalën sepse mendova se Kryesuesja e Komitetit znj.Marigona Pajaziti do ta paraqet vërejtjen e Komitetit, por meqenese ajo nuk po e bën unë po dua me paraqit në Kuvend si vërejtje për drejtorët të cilët nuk po marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit për Arsim, ne si Komitet kemi dalë me një Konkluzion për mospjesëmarrien e drejtorëve në mbledhje të cilët po na e vështirësojnë punën. Nuk është kjo hera e pare që nuk marrin pjesë por ka shumë mbledhje që nuk na vine drejtorët, dhe kisha pas dëshirë edhe kërkoi që kjo të merret parasysh që drejtorët të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport?

z.Herolind Selmani; Kam këto pyetje: Për shqetësimet që pata me i thënë, veq foli Besniku, atë shqetësim e pata për sa i përket mirëmbajtjes së hapsirave publike, mirëpo po ja bëj një pyetje drejtorit, z.Muhadin Halilit, në kontratën që është nënshkruar për mirëmbajtjen e hapsirave publike a përfshihen edhe mirëmbajtja e trotuareve nëpër rrugë në komunën tone, apo vetëm hapsirat siç janë varrezat dhe këto tjerat?

z.Skender Hyseni; Kam këto pyetje: Unë po kërkoi një sçarim, nga drejtori për shërbime publike, te kanalizimi në fshatin Muzeqinë, kish fillu rryma elektrike me u vendosë, nëse parashihet për me

intervenuar aty, atëher mos po bëhen dyfish dëme, sepse prap ata tela duhet me u hjekë, dhe mendoj se këto kabllo kanë me penguar, ndoshta edhe pagesa bëhet e dyfisht?

E përkrahu diskutimin e z.Reshat Mujota, lidhur me vërejtjen për mospjesëmarrjen e drejtorëve në mbledhjet e Komitetit.

z.Fehmi Hysenaj: Unë e kamë një pyetje shtesë. Nuk e mora përgjigjen për një pyetje për çështjen e ujit në Carralevë që po rrjedhë vazhdimisht. Edhe kjo përgjigja e drejtoreshës vërtetë nuk më pëlqejë sepse dihet që kësaj radhe pritet që të vijnë shumë bashkëatdhetarë, dhe vërtetë është imazh i keq i komunës, nëse ata shkojnë tea to kafiteri, dhe aq më keq që ndoshta paguajnë për atë pjesën që e shfrytëzojnë para kafiterive dhe aty nuk mund të rrijë askush nga kundërmimi. Është mire që të sanohet së paku përkohësisht, e pëastaj qështja e kanalizimit të vazhdojë?

Pyetja tjetër është, në rrugën “Anton Çeta” janë bërë shtigjet e biçikletave por nuk e di kush e ka projektuar në atë mënyrë që skijored të ndahen ku janë pusetat, vërtetë është shumë e keq e që skajori te pusetat ku rrjedhë uji atmosferik është ndarë në gjysëm, nëse i viziton i shihni ato?

z.Naim Zejna; Më mbeti pa e lexuar edhe një pyetje që po më duket është e rendësishme për qytetarët e Shtimes, pyetja është për drejtorin e shërbimeve publike, ekziston një dukuri drejtor që çdo mbrëmje kemi ndalje të ujit të ujësjellësit në Shtime ose zvogëlim të shtypesës së ujit po më intereson pse, dhe po më intereson sa Kyqje janë të rexhistroara e që kanë ujëmatës në Shtime, dhe sa janë paushall, spse tash në këtë kohë të vapës po shpenzojnë ujë duke ujitë hapsira të ndryshme, dhe kështu po ka mungesë të ujit?

z.Muhadin Halili – DPP; Përrshëndetje, sa për sqarim po përmendi se Kontrata për mirëmbajtje ende nuk është nënshkruar, është në fazën e vlerësimit. Sa i përket mirëmbajtjes të cilat janë të parapara si mirëmbajtja e parqeve, varrezave, kanalizimeve, rrugëve, është kontratë korrnizë, nuk është kontratë që ka me u përfunduar si projekt por është kontratë në vazhdimësi si kontratë korrnizë 36 muaj, në specifikacion është paraparë dmth. të gjitha duke filluar varrezat, trotuaret, ndriçimi public të gjitha janë dmth. të specifikuara që janë në paramasë dhe paralogari, mirëpo kontrata ende nuk është nënshkruar, kaq flm.

z.Hamëz Tërshani – DSHP; Sa i përket kanalizimit në fshatin Muzeqinë unë po ju njoftoj se gjatë javës e kemi një takim me drejtorin e KRU “Prishtina” edhe aty do të duhet me intervenu. Për vendosjen e rrymës nuk jemi të njoftum mirpo, nuk kemi me lejuar me punu deri sa duhet me intervenuar aty. Faleminderit për informatën, do të interesohemi për këtë dhe do të vendosim. Ndërsa sa i përket ndërprerjes së ujit, informatat janë që ujë ka, mirëpo kërkesa është në rritje, dmth. mundet me pas ulje të volumit të ujit. Sa i përket ujëmatësve dmth. për momentin nuk kam informatë të plotë, mirëpo kam me interesuar për mes zyrtarëve që janë kompetent dhe ju njoftoj ose në mbledhjen e radhës ose ua dërgoj në formë të shkruar, pasi që kjo është një shqetësim i arsyeshëm edhe për neve të gjithëve. Inspektorat non stop janë në teren, dhe kjo dukuri duhet luftuar me qëllim që ata që paguajn dhe janë të rregullt mos me pas pasoja të mungesës së ujit.

z.Besnik Seferi; Kam këto pyetje: Edhe pse pak a shumë u dha sqarim për kontratën e mirëmbajtjes, mirëpo unë desha me ditë saktësisht vlerën e kontratës, dhe kurë do të ndodhë sakt, sepse po bëhet një vit që jemi duke e kërkuar, bile për disa rrugë shqetësimet i kam ngritë aqë shpesh sa po më duket se edhe u bë bajat më duke kërkuar sqarime se kur do të pastrohen parqet, edhe trotuaret në rrugën “Anton Çeta” edhe në rrugën “Çamëria” po duam ta dime saktësisht kur do të bëhet?

z.Muhadin Halili – DPP; Vlera e parashikuar e kontratës për mirëmbajtje është 360.000€ kjo është kontratë korrnizë për 36 muaj. Ende nuk është nënshkruar kontrata. Nuk do të thot që kjo vlerë e parashikuar është edhe vlerë e kontraktuar. Është në fazën e vlerësimit. Në momentin e nënshkrimit do të jetë publike për opinionin.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Përrshëndetje, po besoj që për disa nga pyetjet e juaja keni marrë përgjigje, sikurse që disa të tjera kërkojnë përgjigje më të sakta në të ardhmen. Ajo që ka të bëj me ujin atmosferik në Carralevë, është një adresim i çështjes në Ministrinë e Infrastructure, është një

problem që duhet të zgjidhet dhe nuk guxon të hyjë në muajt e dimërit për shkak të ngricave, është përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë sepse është rrugë rafionale. Pjetje pati për numër të punëtorëve me kontratë në vepër, përgjigja është se në Komunën e Shtimes nuk ka asnje. Ne kemi kontrata vetëm për punëtorët sezonal të 2 Zjarrëfikësve që kanë kontrata të shërbimit që dmth. është e rregullueme. Asnjë kontratë në vepër në Komunën e Shtimes nuk është. Kjo pra është e vërteta, bila nuk kemi as përbushje të numrit të punëtorëve në administratën komunale, në bazë të numrit që neve na lejohet, përfaktin që kemi tani më një Ligj të zyrtarëve publik i cili nuk po mund të implementohet, që është neglizhencë e stërgjatur e Ministrisë të Punëve të Brendshme, e cila ka futë në funksion një Ligj të zyrtarëve publik por që Ligji i Pagave nuk është funksional, mungojnë udhëzimet administrative, dhe Komunat sot nuk mund të marrin asnje punëtorë, edhe pse kërkesat dhe nevojat janë. Çështje tjetër me rendësi ishte qështja e kontratës, kështu që ne po planifikojmë që së paku vlerësimi të përmbyllët këtë javë, periudha e aplikimit mund të na i merr edhe 10 ditë, mirëpo pas periudhës dy javore ne do ta kemi kontratën dhe reagimet e para të kontraktorit duhet të jenë që ti zgjidhi gjitha këto problem të cilat janë jetike në këtë kuptim të mirëmbajtjes që hyjnë trotuaret, rrugët, parqet, hapsirat tjera publike, problematike ngelë edhe më tutje çështja e azhurimit të punëvew të cilat i bëjnë ndërrmarjet publike. Edhe KRM "Pastërtia" edhe KRU "Prishtina". Realisht mbi bazën e rrjetit dhe potencialit që e kanë nuk janë duke e ushtruar kompetencën e tyre në nivelin e duhur. Ne krejt e dime se Shtimja ka ujë të mjaftueshmë, se kemi ujë nëntokësor, dhe nuk mund të ketë dhe sdo të ket reduktimi. Mirëpo ndodhë që politika e Prishtinës që është Liqeni i Badovcit, aplikohet nganjëher në Shtime, për puset nëntokjsore që i kemi, është dmth. kompletnë neglizhencë e tyre. Por me shumë është neglizhimi i tyre në menaxhimin e rrjetit të kanalizimit që është punë dhe përgjegjësi e tyre. Ata e marrin taksën e qytetarëve, po nuk e kthejnë shërbimin. Kanalizimet atmosferike janë tonat, mirëmbajtja e tyre, hapja e tyre nëse ato mbyllen, dhe ato janë të parapara me kontratë. Ne do të reagojmë me këto çështje që janë shumë emërgjente, Brenda kësaj jave intervenimet duhet të jenë në dy segmente, edhe te pjesa e parkut edhe te pjesa e fshatit Muzeqinë, që janë shumë të nevojshme, dhe ato do të jenë një punë e përbashkët e jona dhe e kompanisë "Prishtina" me emërgjencë që do të bëhet. Çështja e Banesave, Komisioni është i formuar dhe nuk ka arsyesh më shumë se sa në mbledhjen e radhës që ta bini një raport, ju punën e keni kry, unë e di që drejtoria, ekzekutivi ju ka asistuar në secilin informacion që keni pas nevojë, e di që keni bërë edhe vizitën aty kështu që kur ta sjellni një raport, të gjitha mundësitë i keni ju duhet thjeshtë në muajin Korrik ta bini reportin, qka do që ka nevojë për asistencë teknike prej ekzekutivit keni me pas, edhe në dokumenta edhe në teren, dhe duhet me përfundu më shpejt reportin e gjendjes në teren. Të gjitha vendimet e Kuvendit implementohen. Vendimi i Kuvendit për deponinë Inerte, është i implementuar dhe si produkt i saj ne kemi kontratën me Agjensionin e Pyjeve, ka një problematic aty që psh. të pengesës të disa banorëve, që kanë penguar deri sa ne nuk po e gjejmë operatorin, sepse kompania "Pastërtia" nuk po e ka kapacitetin këto me i menaxhuar si duhet. Ato janë prona të Pylltarisë por aty ka disa pretendime të disa fshatarëve të Belincit që janë e të Davidovcit se këto prona kanë qenë të tyre dikur, kështu që kanë ngelë me Ministrinë dhe me Agjensionin e Pyjeve ta definojnë qartë çështjen që në këtë rast ne e kemi përcaktuar si deponi. Unë besoj që shumë shpejtë ne do ta gjejmë edhe se cili do të jetë formati i menaxhimit të asaj deponie. Te sheshi ne do të kërkojmë nga Policia që me qenë më azhuriteti aty pak më i madhë. Të gjithë ata të cilët janë banorë dhe bizneset do ta gjegojnë të drejtën e tyre të çasjes. Por të gjithë të tjerët dmth. nuk kanë nevojë që aty të kenë qasje me vetura sepse ai është shesh. Ne për më tepër e kemi ndërtuar një parking përballë Xhamisë, që është me këtë destinim.

Z.Ruzhdi Jashari: U tha se të gjitha vendimet e Kuvendit implementohen, nuk është ashtu, pse, pot a sjelli në vëmendje vetëm një vendim, e jo më shumë, kam thënë bjeri në Kuvend e që nuk është bërë, është e lehtë vetëm të bëhet një inventarizim i tyre, a ka justifikim pse? Po e përmendi vendimin që jemi marrë me te 3-4 mbledhje në Kuvend, për sa i përket emërtimit të objekteve publike, i cili nuk është implementuar, kemi pas kërkesa të qytetarëve për emërtimin e objekteve

publike, unë po sqaroj se nuk është implementuar si vendim, nuk kanë ndodhur emërtimet, për këtë arsyе unë po them bjeri të gjitha këtu në Kuvend, që ta dime se cilat nuk janë implementuar?

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Po dua vetem të sqaroj se sa i përket këtijë vendimi ne e kemi marrë këtë vendim si Kuvend dhe e kemi bërë edhe hapin e pare, sa për vëmendjen tënde dhe e kemi ftuar edhe Komisionin që është themeluar ku e kanë zgjedhur edhe kryesuesin e komisionit, dmth. këtu qëndron puna dhe tash vetëm duhet të vazhdohet deri në fund puna e Komisionit, kështu që ky nuk është vendim i pa zbatuar i Kuvendit, sepse janë bërë hapa tutje.

Kryetari, z.Naim Ismajli; E thash dhe qëndroj në ate që e them, nuk ka vendime të Kuvendit të pa zbatueshme; edhe ky vendim i Kuvendit, ku fillimisht ka themeluar komision, që të diskutojë, që të nxjerrë rekomandime, për emërtimin e objekteve publike, dhe Kuvendi nuk ka vendosur ende për emrat, janë dy gjëra shumë të ndryshme, vendimi zbatues dhe vendimi për punë të komisionit. E Kryetarit nuk është që të ndërhyjnë në punën e Komisionit, por kur komisioni i sjell rekomandim Kuvendit, dhe Kuvendi vendos për emërim, ne kemi me e zbatuar vendimin edhe ate kur konfirmohet ligjshmëria nga MPL. Dhe nuk kamë nevojë me bërë inventarizimin e vendimeve, sepse krejt ato vendime janë të inventarizuara në Sekretarinë e Kuvendit.

z.Reshat Mujota; Sqarimin e dha Kryetari, mos ti përsëriti fajalët sepse nuk është marrë vendim për emërim por u votu komisioni. Kryetar i atijë komisioni jamë unë, ku edhe Vetëvendosja e ka anëtarin e vetë, dhe e din se deri ku ka shkuar puna në këtë komision, ashtu është e dhe nga LDK-ja një anëtarë, ne kemi punuar dhe jemi duke i shqyrtuar kërkasat. Unë bvesoj që në mbledhjen e ardhëshme, do të ju vijnë propozimet, kështu që ne si komision kemi me rekomanduar për mbledhjen e Kuvendit. Unë e di që shumica e Kuvendit edhe kta nuk kanë qenë të gatshëm me vendosë edhe sikur të vinin propozimet më heret, sepse kërkasat janë shumë të mëdha, unë po dua që mos të biem në lajthitje kur vijnë propozimet e pastaj me dale me propozime të reja, e me u shkel puna e komisionit. Unë po e garantoj zotin Jashari se në mbledhjen e ardhëshme do ti ketë propozimet nga Komisioni.

z.Rexhep Gashi; Është shumë e vërtetë që mirëmbajtjen e kanalizimeve të ujësjellësit e kryen KRU "Prishtina" por është një faktorë shumë i rendësishëm se te pranimi teknik i kanalizimeve po e bëjmë na dhe kur po e bëjmë na nuk po jemi fort serioz dhe po ja japim atyre një projekt jo të punuar mirë. Unë mendoj që gjatë ptanimit teknik të kanalizimeve, mos u kanë mire që ne me e marrë edhe një përfaqësues të KRU "Prishtina" që e përfaqësojnë Shtimen edhe Kryetar të ja japim, edhe pak përgjegjesi atyre, sepse ata po ankohen që po bëhet pranimi teknik jo adekuat, sepse po e shohim ne se si po pranohen dhe nga kush po pranohen, kështu që mosfunkcionimi i tyre ne si popull po i vuajmë pasojat, ndërsa barren po ua gjuajmë KRU 'Prishtina'.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, Kryesuese tu kasha lutë me e zbatuar Rregulloren e punës së Kuvendit. Rregullorja e Kuvendit e jep që për një temë anëtar i Kuvendit me pas një here fjalën, e jo këtu siq po ndodhë sa here që ti bjen ndërmend dikujt me marrë fjalën, kështu që të kasha sygjeruar me e zbatu rregulloren e Kuvendit dhe jo me i dhënë fjalën anëtarit për pytje-përgjigje 3-4 herë, flm.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Pika Pytje –Përgjigje është e njejtë sikurse të gjitha pikat tjera, dhe njejtë trajtohet, kështu që anëtar i Kuvendit ka të drejtë dy herë ta merr fjalën, dmth. në bazë të Rregullores së punës, kështu që nuk jam vetëm unë por edhe ju e keni ngritur dorën për aprovin e kësaj rregullore, prandaj edhe këtë rregullore jemi duke e zbatuar. Le të mbetet pak edhe në ndërgjegjen e juaj se a bënë ose jo që ta ngarkoni mbledhjen me gjërat të cilat u bien ndërmend juve aty për aty. Ju kisha lutë dhe ju bëj thirrje, që para ç'do mbledhje t'i precizoni pyetjet e juaja që i keni, të jeni konciz, dhe pastaj do ti merrni edhe përgjigjet konkrete, po kërkoj bashkpunimin e juaj që gjërat të ecin përpara pak më mirë, flm.

Pika 2

Draft-Korrniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024, (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Bujar Ferati.

z. Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Përshëndetje, KAB-in që ne sot po e prezantojmë para jush është pra dokumenti bazë për aprovimin më vonë të Buxhetit të Komunës sonë. Baza ligjore është konsultuar dhe është përbledhur në dokument. KAB-i tani më siç e dini miratohet për çdo vit kalendarik, mbi bazën e dokumentit bazë të KAB-it i cili vjen nga Ministria e Financave ku janë vendosë kulmi ose tavanet e shpenzimeve buxhetore mbi të cilat nuk mund të kalojmë. Ne kemi pas takime të shumta dhe diskutime publike për sa i përket KAB-it 2022-2024, kemi pas takime pune edhe si Kuvend me puntori të ndryshme. Diskutimet nuk kanë rezultuar si të suksesshme, sepse nuk ka pas propozime konkrete të aresytuara. Sa i përket puntorisë të Kuvendit të organizuar në Durrës-Shqipëri, të gjitha propozimet i kemi evidentuar dhe mund tua jap me shkrim, (shih dokumentin). Por për sa u përket kërkesave dhe propozimeve që kanë dalë në këtë puntori, përgjigjet i keni marrë aty për aty. Projekte të tjera nuk mund të futim në KAB. Nëse ka ndonjë pyetje, jam këtu për tu përgjigjur, unë pres se do ta aprovoni KAB-in në këtë mbledhje.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për këtë pikë, lexoi edhe rekomandimin e KPF-së.

z.Perparim Ramusa; KAB 2022-2024 është një dokument i cili i cakton prioritetet e Komunës për këtë periudhë kohore. Unë edhe në mbledhjet e kaluara kam kërkuar që rruga “Shtegu i UÇK” në fshatin Godanc i Epërm të futet në dokumentin e KAB-it 2022-2024, sepse realisht ky projekt i cili i lidhë fshatrat Godanc i Epërm – Zborc e ka rëndësinë edhe për faktin sepse ka qenë rrugë me rëndësi përfurnizimin e UÇK-së me ushqim edhe me material tjetër të nevojshëm, ky projekt pra ka qenë në dokumentin e KAB-it edhe në vitin e kaluar dhe nuk e di përfar arsyё është larguar.

z.Muhamed Ademaj; E falënderoj drejtoren për prezantimin e KAB-it. Në muajin Shtator ky do të qartësohet edhe më mirë me miratimin e buxhetit të Komunës, kështu që unë e mbështes miratimin e KAB-it 2022-2024.

z.Fehmi Hysenaj; E falënderoj Bujarin për prezantimin e KAB-it. Sa i përket debatit publik, mund të them se nuk ka pas pjesëmarrje, as me publik e as me subjektet politike, prandaj unë po kërkoj organizimin e një trajnimi për sa i përket përgatitjes së dokumentit të KAB-it, sepse ka kolegë që nuk janë mjaftueshëm të njojur me KAB-in. KAB-i duhet ta ketë fokusin në periudhën 2022, sepse përvitet 2023 dhe 2024 ka mundësi që të ndryshohen. Edhe projektet e propozuara, unë mendoj se duhet të merren parasysh, dhe të adresohen. Nuk e di përfar stacionin e vjetër të policisë se çka do të bëhet me te, sepse ka pas propozime që të ruhet si objekt përkujtimor për keqtrajtimet që u janë bërë shqiptarëve në këtë objekt gjatë kohës së okupimit serb.

z.Reshat Mujota; Unë desha të bëj vetëm një sçarim, fjala në pyetjen time ka qenë për sa i përket trotuarit dhe ndriçimit në rrugën nga Halla Sportive e deri te lagja e Mujotëve në fshatin Mollopolc.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, kam marrë pjesë në puntori në Shqipëri, dhe nuk ëspshtë bërë rruga deri te shpella në pjetërshticë. Po ashtu e kemi ngritë esdhe çështjen e ndërtimit të një nën ose mbi kalimi në Pjetërshticë, ku u dhanë arsyetime të ndryshme, mirëpo unë mendoj se duhet të shfrytëzohen të gjithë mekanizmat që këto të bëhen, sepse ka njerëz që kanë mbetur invalid në Pjetërshticë. Klubi i biznesit e ka bërë një kërkesë përfullimin e infrastrukturës në dalje të rrugës Shtime-Ferizaj.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Projektet që do të akomodohen me vlera në buxhet për vitin 2022 e tutje janë: Kanalizimi në lagjen Ademaj. Trotuari në rrugën përfullimin e rrugës “Shtegu i UÇK” Godanc i Epërm-Zborc. Pastaj rruga “Idriz Seferi” po ashtu do të akomodohet. Kanalizimi i rrugës “Qamëria”. Trotuaret në rrugën Qestë-Reçak, faza e dytë. Rregullimi i trotuareve te shkolla “Emin Duraku”, hapësirë përsiguri. Trotuari i rrugës “Ismajl Qemajli” në fshatin Zborc. Projekti i mënjanimit të mbeturinave dhe furrave gëlqerore. Rruga deri te shpella e Pjetërshticës. Nënkalimet, në rrugët e

fshatrave në Davidovc, Carralevë, Pjetërshticë dhe në Shtime. Si dhe projekt i trajtimit të ujërave në Carralevë.

z.Ruzhdì Jashari; E falenderojmë ZKF-në për prezantimin. Nuk duhet asesi të eleminojen kanalizimet fekale. Ne me këmbëngulje po kërkojmë qëndrueshmëri të projekteve, e jo ato të bëhen shkel e shko. Ne duam të ngrisim çështjen e specifikimit të projekteve që nuk ka specifikim, këtë gjë po e kërkojmë që disa mbledhje rresht të Kuvendit. Prandaj po e bëjmë me dije se pa specifikim të projekteve ne nuk do ta votojmë KAB-in. Kjo qasje duhet me doemos me u ndrruar. Nuk ka debate të mirëfillta dhe të suksesshme me qytetarë. Propozimet që i kemi paraqitur ne nuk kanë zënë vend në KAB, sikurse ishte propozimi ynë për pagesën me 100€ për çdo fëmi të lindur. Nuk është bërë shejëzimi siç kemi kërkuar i vendeve ku ka vepruar UÇK-ja. Sa i përket nënkalimeve komuna e Ferizait i ka bërë edhe në rrugët që menaxhohen nga niveli qendror ka shembuj të mjaftueshëm.

z.Naim Zejna; E përvihendës ZKF-në për prezantimin si dhe që shumica e projekteve që i kemi propozuar ne janë inkorporuar. Ka mbetur pa u përmendur edhe pozicioni i Serrës te shkolla Profesionale.

z.Shekfi Dauti; Këtë herë ka pas diskutime të ghjata për KAB-in. Unë po kërkoj që bile në debat me qytetarët mos të kemi paqartësi.

z.Besnik Seferi; Te projektet nuk ka specifikim, ka qenë e domosdoshme që të bëhet specifikimi i secilit projekt veç e veç. Sa i përket çështjes së kanalizimit në fshatin Carralevë, çka ka ndodhur me kanalizimin fekal nga lagja Feka deri te lagja Beha. Duam ta dimë saktësish te lagja "Zeqiri" në fshatin Davidovc a do të përfshihet kanalizimi meqenëse aty tash më veq ekziston asfallti. Te Lagja e Pajtimit, në disa vende ka filluar ndërtimi i kanalizimit, por te rruga "Tranzit" kundërmon era, kështu që është mirë me u planifikuar edhe aty e mos të vazhdohet me projekte pa mirëmbajtje.

z.Muhamed Ademaj; E falënderoj Kryetarin për përfshirjen e projekteve, ndërtimi i trotuarit në rrugën për Mollopolc nga Halla Sportive deri te lagja Mujotëve, si dhe projektin e Kanalizimit në lagjen Ademaj.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Në Carralevë kanalizimi, po janë të parapara, dhe do të përfshihen në dokument. Shumica e fshatrave do ta kenë edhe ndriçimin. Sa u përket nënkalimeve ne do të bëjmë kërkesa në nivelin qendror, ndërsa në brendi të qytetit është kompetent Komuna. Te rruga "Zeqiri" është në përfshirjen e projektit për Davidovc. Te Serra te shkolla profesionale do të shohim se si dhe çka mundemi me bërë. Sa i përket rrugës "12 Qershori" janë aprovuar mjetet dhe sivjet realizohet projekti. U tha se projetat po orientohen sipas partive politike, sot në një shtëpi i kemi 2-3 subjekte politike, kështu që nuk ka më projekte për PDK-në e LDK-në. Edshe projektet që nuk mund të përfshihen sivjet, nuk janë hiq më pak të rëndësishme mirëpo mundësit buxhetore janë këto. Unë mendoj se një dokument me një renditje të tillë të projekteve e meriton për ta votuar. E vlerësoj kontributin e juaj në punëtorinë e organizuar në Durrës-Shqipëri.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ju falënderoj për diskutimet e sotme për KAB-in, por edhe diskutimet dhe kontributin e juaj në punëtorinë e organizuar në Durrës-Shqipëri. Në vazhdim, konstatoi Kuorumin prej 20 delegatëve prezantë në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 17 vota "Për" me 2 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" aprovoi, Korrnizën Afatmesme Buxhetore, 2022-2024.**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Dha 10 minuta pauzë në ora 11.55h. Mbledhjen Kryesuesja e vazhdoi në ora 12.10h.

Pika 3

Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Kuvendit në Komisionin për ndarjen e Bursave për Studentë, për vitin akademik 2020/2021

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Para se të ja japi fjalën znj. Agime Roshaj për prezantimin e kësaj pike, Kryesuesja lexoi Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Rekomandimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

znj. Agime Roshaj, drejtoresh e DKA; Përshëndetje, unë dua të jap sqarime pak lidhur me Rekomandimin e KAKRS-së për anulimin e Konkursit për ndarjen e bursave për studentë, konkursi është bërë sipas rregullores për ndarjen e bursave për studentë, si dhe në bazë të qelësit të rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Në propozimin tonë i kemi dy emra nga ekzekutivi z. Fatmir Zymeri, zyrtarë i DKA-së dhe znj. Ardita Ndrecaj, ndërsa nga shoqëria civile e kemi emrin e z. Resul Gashi.

z. Shefki Dauti; Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave për studentë është bërë nga drejtoria e arsimit, ndërsa që unë propozoj që ky konkurs të anulohet, për arsy se në atë konkurs nuk e kemi të precizuar për secilin fakultet sa studentë do të përfitojnë bursa, e unë mendoj se duhet të bëhet me qëllim që ne të stimulojmë studentët në drejtimet deficitare ku edhe realisht kemi shumë pak të interesuar. Me këtë konkurs të hapur po krijohet mundësia që të përfitojnë një kategori e caktuar jo meritorë të studentëve në fakultet private, për këtë arsy unë kërkoj të anulohet, dhe të shpallet konkurs i ri në të cilin do të përfshihen edhe kriteret që i ka caktuar Komisioni për ndryshimin e rregullores për ndarjen e bursave për studentë. Kemi shumë fakultete që asnjëherë asnjë studentë nuk kanë marrë asnjë bursë nga Komuna. Shumica e komunave i kanë të ndara profilet ose drejtimet e fakulteteve se sa bursa do të ndahen për secilin prej tyre. Me këtë ndarje ne i stimulojmë edhe studentët e mirë por edhe drejtimet deficitare për të cilat kemi nevojë më shumë për kuadro. Nga grupi i anëtarëve të Kuvendit nga pozita ne propozojmë anëtarë të Komisionit z. Herolind Selmani.

z. Fehmi Hysenaj; Po shihet që nuk ja kemi qëlluar as me rregullore e as me ndarjen e bursave, vitin e kaluar. Duhet shikuar mirë se a është interesi i komunës apo ka interes personale. Puna dhe rekomandimi i Komitetit për arsim është mjaftë e mirë, unë nuk do të kisha lejuar që të shkojë për interesa private, për këtë arsy unë e përkrahu rekomandimin e Komitetit për arsim, kështu që unë jam që konkursi të anulohet. Te pika 6.11 kërkoj që të përmirësohet dhe të shkruehet "Fakulteti Filologjik". Dihet që për këtë qështje Kuvendi Vendasë, ndërsa që drejtoria e arsimit vetëm e jep propozimin.

z. Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, ne si Vetvendosje edhe në KPF-ë jemi deklaruar sipas rekomandimit që është shkruar. Sa i përket specifikave janë në dorën e Komisionit. Kriteret gjithsesi duhet të merren parasysh sipas rregullores për ndarjen e bursave për studentë. Unë e propozoj z. Besnik Seferin që të jetë anëtarë i Komisionit për ndarjen e bursave për studentë.

z. Naim Zejna; E thanë edhe parafolësit pjesën që i përket rekomandimit të KPF-së, kështu që edhe ne mendojmë se gjeneralja është mirë. Te rregullorja është dashtë me lënë që Kuvendi me vendim të veqantë të vendosë për caktimin e kritereve aktuale për fakultete. Te kriteret unë e kuptoj ashtu që viti paraprak është viti që realisht ka shkuar, ndërsa viti vijues është viti shkollor që po vjen. Si LDK-ë u akordua që të propozojmë z. Fehmi Hysenaj. Ne mendojmë se në këtë proces duhet inkadruar edhe Klubin e Biznesit, kështu që ndoshta do të ishte mirë që me e rritë numrin e anëtarëve të komisionit.

z. Besnik Seferi; Unë 100% pajtohem me propozimin e z. Shefki Dautit. Në vitin 2018-2019 unë kam qenë anëtarë i komisionit, dhe mund të them me siguri të plotë se nuk ka pas asnjë lloj keqpërdorimi. Mirëpo kanë fituar drejtimet që nuk kanë qenë deficitare. Për këtë arsy edhe unë propozoj që konkursi të anulohet, të shpallet konkurs i ri në të cilin do të merren parasysh edhe propozimet tona. Pajtohem që me qenë pjesë e komisionit ashti qysh e propozoi z. Ruzhdi Jashari.

z. Fehmi Hysenaj; Duhet me thënë se Komisioni ka punuar në bazë të rregullores. Unë jam që të rishpallet konkursi duke marrë parasysh edhe këto kritere.

z.Naim Zejna; Unë nuk pajtohem me këto, sidomos jo me këto që u thanë demagogji. Nuk është demagogji nëse propozohet që me u rritë numri i anëtarëve të komisionit. Unë jam që të përfshihen edhe elementet e vitit të parë. Kështu që ne ngeleme te propozimi ynë i parë.

z.Rexhep Gashi; Konkursi i drejtorisë të arsimit për ndarjen e bursave për studentë duhet të anulohet. Pajtohem me rekomandimin e KPF-së. Unë e propozoj z.Muhamed Ademaj, për anëtarë të komisionit.

z.Reshat Mujota; Mënyra se si po zhvillohet debati për këtë pikë po tregon se po mundohet sescili përfitimin e poenave politik. Komisioni i ka propozuar po këto kriterë edhe vitin e kaluar por nuk janë aprovuar. Në Komitetin për arsim jemi pajtuar unanimisht dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për aprovim. Unë tash këtu mundem me abstenu, dhe asnjërit mos me ja dhënë votën.

z.Muhamed Ademaj; E mbështes rekomandimin e Komitetit për arsim. Kërkoj që të anulohet konkursi dhe të shpallet konkurs i ri. Unë e falënderoj Rexhën për propozimin që e dha përmua, por unë dua të tërhoqem nga kjo kandidaturë për anëtarë të komisionit për ndarjen e bursave për studentë.

z.Shekfi Dauti; Ne si komision me rregullore kemi punuar, unë kamë votuar "Kundër" dhe prap do të votoj "Kundër", sepse po fitojnë bursa studentët jo meritor në fakultetet private. Ne nuk bëjmë asnje shkelje ligjore nëse bëjmë caktimin e kritereve për stimulimin e drejtimeve deficitare, sepse ato po na mungojnë më së shumti. Pajtohem që anëtarë të komisionit të janë Fehmiu dhe Besniku.

z.Fehmi Hysenaj; Unë diskutimin e pata vetëm për interesin e përgjithshëm. Mendoj se është mirë të thuhet në konkurs "Është e rekomanduar që të kemi edhe çertifikatën e notave nga viti paraprak".

z.Naim Zejna; Edhe unë pajtohem me një propozim të tillë të njëjtë, që mos me lënë vakantë, për sa i përket vitit të kaluar akademik. Unë nuk kamë vërejtje te anëtarët e komisionit, edhe Besniku bënë, por karshi moshës ne e propozuam Fehmiun.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Në bazë të dikutimeve që u zhvilluan vijmë në përfundim se pajtohemi që të anulohet konkursi dhe të shpallet konkurs i ri duke përfshirë edhe propozimet e komisionit, si dhe që në konkurs të përfshihet edhe klauzola "Është e rekomanduar që të kemi edhe çertifikatën e notave nga viti paraprak", i cili do të jetë si rekomandim.

znj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA; I keni ngatërruar rregulloren me kriteret. Ndarja e bursave është bërë në bazë të rregullores, është komisioni që e vërteton këtë, kështu që ne i kemi aplikuar kriteret sipas rregullores.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin prej 17 delegatëve prezantë në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 16 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim"** aprovoi Vendimin pér anulimin e Konkursit Nr.05/272 dt. 16.06.2021 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Shtimes për vitin akademik 2020/2021. Kuvendi i Komunës autorizon Drejtorinë Komunale të Arsimit, që të shpallë Konkurs të ri për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2020/2021, duke marrë parasysh, Rekomandimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport Npi – 01/174 datë: 24.06.2021, si dhe të merren parasysh propozimet e anëtarëve të Kuvendit si vijon:

1. "Është e rekomanduar që dokumentacionit të ja bashkëngjitini edhe dokumentin që i vërteton notat e marra nga viti paraprak", Dhe propozimi i dytë, 2. Te pika e gjashtë të përmirësohet dhe të shkruhet "Fakulteti Filologjik".

* **Kuvendi i Komunës, me 15 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim"** zgjodhi z.Herolind Selmanin, anëtarë të komisionit për ndarjen e bursave për studentë.

* **Kuvendi i Komunës, me 4 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 12 vota "Abstenim" nuk e zgjodhi z.Besnik Seferin, anëtarë të komisionit për ndarjen e bursave për studentë.**

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 6 vota "Abstenim"** zgjodhi z.Fehmi Hysenaj, anëtarë të komisionit për ndarjen e bursave për studentë.

* Kuvendi i Komunës, me 13 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 4 vota “Abstenim” aprovtoi Vendimin për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi, për ndarjen e Bursave për Studentë, për vitin akademik 2020/2021, nga gjithsejtë 5 (pesë) anëtarë sa është paraparë me rregullore, si vijon:

1. z.Herolind Selmani..... (Përfaqësues i pozitës)
2. z.Fehmi Hysenaj.....(Përfaqësuese e opozitës)

Dy anëtarë të Komisionit nga Ekzekutivi:


3. z.Fatmir Zymeri (Zyrtar për Arsim)
4. znj.Ardita Ndrecaj.....(Zyrtare e Personelit)

Një anëtar të Komisionit nga OJQ-të:

5. z.Resul Gashi(Kryetar i Qendrës Rinore - Përfaqësues i OJQ-ve)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ju falënderoj për diskutimet, dhe për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendit, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 13.10h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj